



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1374 Prot.

Tiranë, më datë 15.09.2021

VENDIM
Nr. 559, datë 15.09.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.09.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike në kuadër të projektit ndërtimor “*Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat + 1 kat nëntokë dhe banesë 2 kat + 1 kat nëntokë*”, lagjia 17, rruga “*Doktor Remzi*”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “*B*” të qytetit të Durrësit, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama, aplikues “*JF Architectural Designer*” sh.p.k. dhe zhvillues “*Arela Konstruksion 2019*” sh.p.k;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjektin të licencuar në arkeologji z. Taulant Rama, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike për projektin “*Godinë shërbimi dhe banimi 6 kat + 1 kat nëntokë dhe banesë 2 kat + 1 kat nëntokë*”, lagjia 17, rruga “*Doktor Remzi*”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “*B*” të qytetit të Durrësit”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 3. Rezultati i Sondazhit arkeologjik të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

